



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eglantina Gjermani – kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore publike “Për zbatimin e ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar””, me fokus veprimtaritë e industrisë fasone në vendin tonë.

Marrin pjesë:

Eglantina Gjermani, Orjola Pampuri, Elona Gjebrea Hoxha, Musa Ulqini, Klodiana Spahiu, Antoneta Dhima dhe Floida Kërpaçi.

Mungojnë:

Rudina Hajdari dhe Fatbardha Kadiu.

Të ftuar:

Arben Seferaj – Përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në Ministrinë e Financave

Irida Qosja - Përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në Ministrinë e Financave

Irena Gjoka - Përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në Ministrinë e Financave

Vjollca Braho - Drejtoreshë e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Areti Beruka- Zëvendësdrejtoreshë e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Robert Gajda – Përfaqësues i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Zhulieta Harasani – Përfaqësuese e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)

Mirela Arqimandriti – Përfaqësuese e Aleancës Gjimore për Zhvillim

Edison Hoxha – Përfaqësues i Qendrës për të drejtat e punëtorëve (CLR)

Frosina Gjino – Përfaqësuese e Albanian Occupational Safety and Health Center (AOSHC)

Plejada Gugashi – Përfaqësuese e Olaf Palme International, që mbështet nismat për të drejtat e punëtorëve në Shqipëri

Kol Nikollaj - President i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)

Anisa Subashi - Zëvendës-presidente e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), kryetare e rrjetit të gruas në KSSH

Renato Mucaj – Përfaqësues i punonjësve të Postë-Telekomunikacionit Shqiptar

HAPET MBLEDHJA

Eglantina Gjermeni – ...me të cilët, së bashku me Nënkomisionin e Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas, organizojmë sot seancën dëgjimore.

Në fakt, duam të monitorojmë se si zbatohet ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, por fokusin kryesor e kemi te ndërmarrjet fasone, për të drejtat e grave dhe vajzave.

Kërkoj mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj që seanca të fokusohet kryesisht në këtë objekt diskutimi, për të cilin ne kemi rënë dakord si nënkomision, për hir të programit të punës që kemi miratuar së bashku, për të drejtat e grave në punë, sigurinë, cilësinë e jetës, si dhe shëndetin e tyre, por edhe për faktin se Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shtetërore para 1 muaji ka qenë në Komisionin e Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ka raportuar punën e tij.

Kështu që unë kërkoj sot të jemi të gjithë të fokusuar vetëm te zbatimi i ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, për tregun e punës dhe të fokusohemi tek të drejtat e grave dhe vajzave në ndërmarrjet fasone.

Kemi menduar që të diskutojmë për problematikat që hasen në zbatimin e ligjit, nëse ka nevojë për ndryshime, përmirësime ligjore apo hartime aktesh nënligjore, të cilat ne si nënkomision mund t’ia kërkojmë qeverisë apo ministrave përkatës që t’i realizojnë.

Po kështu, kërkojmë mendime, sugjerime, *feedback* nga ju për atë që Nënkomisioni i Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas mund të bëjë, se si ne mund t’ju ndihmojmë më shumë në punën tuaj, çfarë mund të bëjmë që të drejtat e grave në tregun e punës (konkretisht, në industrinë fasone) të respektohen dhe të mos abuzohet me të drejtat e tyre në këtë industri.

Kemi disa të ftuar. Nuk po i përmend emrat. Kemi ftuar përfaqësues nga: Ministria e Ekonomisë dhe Financave, konkretisht, nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Organizata Ndërkombëtare e Punës; Aleanca Gjinore për Zhvillim; Qendra për të drejtat e punëtorëve; Olaf Palme Internacional; Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, si dhe Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomunikacionit shqiptar.

Sot ka qenë një ditë e ngarkuar dhe vazhdon të jetë e tillë. Disa nga komisionet kanë mbledhje, prandaj një pjesë e kolegëve nuk janë këtu. Gjithsesi, kërkoj që secili prej jush në momentin kur të marrë fjalën të flasë në mënyrë të përmbledhur për problematikat dhe sugjerimet konkrete. Më pas do të kemi pyetje dhe diskutime.

Do t'ia jap fjalën zotit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Orjola Pampuri – Ju uroj mirëseardhjen dhe ju përshëndes të gjithëve!

Në fakt, në rolin e nënkryetares së këtij nënkomisioni, në një normalitet të tillë, po diskutojmë një temë, që, normalisht, është e rëndësishme. Jo më larg se mëngjesin e sotëm, një punonjës i Gardës, përfaqësues i shteti, vrau gruan. Jo më larg se dje, një punonjës i policisë bëri një akt të turpshëm, të dënueshëm. Jo më larg se para një jave kemi përsëri një akt të turpshëm dhe të dënueshëm në Kavajë. Pra, jemi përballë tri rasteve, zonja kryetare. Unë jam shumë e interesuar për këtë temë, por ishte emergjente që sot të kishim një nënkomisioni ku të trajtoheshin tema të dhunës me bazë gjinore të fëmijët, tema të dhunës në familje, siç ishte rasti i punonjësit të Gardës, që vrau gruan, si dhe rasti i djeshëm i paprecedentë i punonjësit të policisë, i cili jo vetëm që është i dënueshëm, por sot ministri Sandër Lleshaj duhet të kishte dhënë dorëheqjen.

Në emër të opozitës kërkoj që Sandër Lleshaj të dorëhiqet përballë tri rasteve të paprecedenta që ndodhën brenda pak ditëve.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Pampuri!

Në fakt, për shkak të mungesës suaj të gjatë në parlament, nuk keni qenë pjesë e planit tonë të punës, të takimeve që kemi bërë për mekanizmin e referimit të dhunës dhe mënyrës se si zbatohet, si dhe me të gjitha hapat që kemi ndërmarrë më tej për të ndjekur punën në çdo bashki...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk do të shtosh, sepse do të mbaroj unë.

Rastet që përmendët janë tronditëse dhe është e vërtetë që janë shqetësuese për të gjithë ne. Pavarësisht mbledhjes ose jo të nënkomisionit, rastet janë ndjekur nga ne hap pas hapi dhe po ndiqen me strukturat përkatëse, me shoqërinë civile si dhe me institucionet që merren me këtë gjë. Jam shumë dakord me ju, janë vërtet raste tronditëse.

Në orën 13:30, siç ju kam njoftuar, kemi një takim pikërisht për këtë çështje, por tani jemi mbledhur për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë në punë, që ishin parashikuar në kalendarin e punës sonë para kësaj... Për shkak të këtyre emergjencave, në orën 13:30 duhet ta kemi mbaruar këtë mbledhje, sepse kemi një takim për dhunën në familje. Kështu që, ju lutem, t'i respektojmë të ftuarit dhe të vazhdojmë punën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq! Mund të prevalojë, por po të them se në orën 13:30...

Orjola Pampuri – Nuk mund të diskutosh për sigurinë në punë kur keni një polic që zhvishet përballë të miturve, kur keni një punonjës të Gardës që vret gruan që në mëngjes, kur keni 8 adoleshentë që përdhunojnë një fëmijë, një të mitur dhe, përpos kësaj, kur shkelni edhe kodin ligjor, duke i nxjerrë prindërit me fytyrë, duke i detyruar. Për të mos thënë pastaj se kush janë prindërit e vajzës, se ku punojnë e të tjerë, që janë punonjësit tuaj... Tani, të gjitha këto janë akte të paprecedenta, që përballë një situatë të tillë na bëjnë paksa hipokritë. Ne të diskutojmë qetësisht për sigurinë në punë, kur atje...! Kjo është e paprecedentë!

Elona Gjebrea Hoxha – Zonja kryetare, dua t'ju bëj me dije se Komisioni i Sigurisë sapo ka mbaruar një mbledhje, ku kishim thirrur drejtorin e Akademisë së Sigurisë, ku kemi diskutuar dhe kemi bërë pyetje. Tani, se çfarë qëndrimi ka qeveria jonë për të gjithë abuzuesit, ne e kemi treguar. Ndërkohë...

Orjola Pampuri – Ju u bëtë vetë abuzues, sepse shkoi ministrja juaj dhe i nxori me fytyrë...

Elona Gjebrea Hoxha – Ju keni pasur raste, që kanë qenë për burg dhe nuk keni bërë këtë... Kjo është fare e tepërt tani! Të vazhdojmë me temën dhe të mos devijojmë!

Orjola Pampuri – T'i marrësh prindërit dhe t'i nxjerrësh me dhunë, me figurë dhe zë, këtë e keni bërë ju. Nuk ka kuptim që dy ministrat të vazhdojnë në detyrë. Ministrja sot duhet të ikte bashkë me ministrin Sandër Lleshaj.

Eglantina Gjermeni – Nuk mund ta marrësh fjalën, më vjen keq!

Orjola Pampuri - Nuk ka kuptim kjo.

Eglantina Gjermeni – Për ty mund të mos ketë kuptim. Je e lirë të qëndrosh ose jo.

Kjo është një çështje po kaq e rëndësishme, që prek të drejtat e grave dhe po flasim për sigurinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Në momentin kur jemi mbledhur për këtë gjë, do të diskutojmë për këtë.

Do të fillojmë direkt me grupet e interesit, për hir të respekti, por edhe të rëndësisë së çështjes, sepse vërtet na prek shumë.

Për sa i përket çështjes dhe emergjencës, i kemi paraprirë, zonjë, edhe me mbledhjet e mëparshme, në të cilat ju nuk keni marrë asnjëherë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me vjen keq...!

Orjola Pampuri – Ministrja Spiropali nxori me zë dhe figurë dy prindër të detyruar... I detyruan të dalin aty. Nuk ka prind, zonjë, të dalë me zë dhe me figurë e ta bëjë kaq publik rastin e fëmijës së tij. Kjo nuk ka kuptim!

Eglantina Gjermani – Ju lutem!

Zoti Seferaj, keni fjalën. Ju lutem, flisni në mënyrë të përmbledhur për problematikat që keni vënë re për zbatimin ose jo të ligjit dhe çfarë mund të bëjë konkretisht Nënkomisioni i Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas!

Faleminderit!

Arben Seferaj –Përshëndetje të gjithëve!

Falënderoj zonjën Gjermani për ftesën që na bëri, si institucion që merremi konkretisht me çështjen për të cilën keni kërkuar të bëjmë këtë seancë dëgjimore.

Falënderoj deputetët, që janë të pranishëm sot në këtë seancë! I falënderoj për faktin se në këto tryeza në mënyrë të vazhdueshme dalin problematika, shqetësime dhe më pas vijne adresimet për zgjidhjen e tyre!

Para se të dal te çështja konkrete, doja të bëja një përmbledhje të shkurtër për rolin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Është një institucion i ngarkuar për kontrollin e dispozitave ligjore, që rregullojnë fushën e punës së të gjitha aktiviteteve ekonomike, private dhe shtetërore, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kuadri ligjor për sigurinë dhe shëndetin në punë në Shqipëri është përmirësuar me aktet ligjore dhe nënligjore. Ligji nr. 10237 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ka transpozuar në mënyrë të plotë direktivën kuadër nr.89391. Në mbështetje të politikave për sigurinë dhe shëndetin në punë është hartuar edhe dokumenti politik për sigurinë dhe shëndetin në punë, në të cilin, përveç autoriteteve të tjera përgjegjëse për këto çështje, është mirëpërcaktuar edhe roli i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Trupa inspektuese përbëhet nga 98 inspektorë pune, të organizuar...

Eglantina Gjermani – Ju lutem, zoti Seferaj, meqenëse materiali u është dërguar të gjithë deputetëve dhe ata kanë pasur mundësinë ta lexojnë, dua të bëni një përmbledhje të problematikave që keni vënë re nga inspektimet, se si mund t’ju ndihmojmë ne dhe çfarë nevojash ka.

Arben Seferaj – Jo pa qëllim e fillova me këto, për të parë se si funksionon inspektorati, sepse nëse ju, realisht, doni të jepni një ndihmesë të vyer për Inspektoratin Shtetëror të Punës, duhet të kuptoni mënyrën se si funksionon ky inspektorat, se si është organizuar, me çfarë trupe, që na jep produktin cilësor në fund të... Jo më kot e lexova këtë pjesë. Gjithsesi, po vazhdoj.

Aktualisht, Inspektorati Shtetëror i Punës ka ndërmarrë një sërë masash konkrete për monitorimin dhe rritjen e eficiencës së procesit inspektues në tregun e punës, pasi struktura aktuale nuk mundëson një monitorim të plotë të veprimtarisë të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

Pjesë e të gjitha raportimeve tona është fakti se vetëm 5% e subjekteve mbulohen me inspektim nga inspektorët e punës. Nisur nga ky fakt kemi parë si domosdoshmëri gjetjen dhe vënien në zbatim të mekanizmave të duhur, që të na japin mundësinë e planifikimit cilësor të subjekteve, që duhet t'i inspektojmë.

Gjatë fundit të vitit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore lançoi matricën e dënimeve, si një platformë e aksesueshme në fazën zyrtare të institucionit tonë. Kjo e fundit, gjatë këtij viti, ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm.

Para se të kërkojmë zbatimin e standardeve të punësimit nga biznesi, duhet të vendosim standarde në punën tonë. Pikërisht kjo platformë do të na e mundësojë këtë.

Konkretisht, do të japë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapacitetit profesional të inspektorëve të punës, pasi jep mundësinë e orientimit të qartë në legjislacionin e punës, i cili, për hir të së vërtetës, ka një numër të konsiderueshëm dispozitash ligjore (rreth 3000) për t'i kontrolluar. Tashmë është i grupuar sipas çështjeve konkrete.

Gjithashtu, përmes kësaj platforme do të sigurojmë një proces inspektimi krejtësisht transparent, duke ulur në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës. Mundësia e vetëkorrigjimit të punëdhënësve, të cilët kanë mundësinë e aksesimit në këtë matricë, rrit ndërgjegjësimin e tyre. Ky ndërgjegjësim përkthehet drejtpërdrejt në përmirësim të situatës së punësimit për punëmarrësit. Trajtimi i barabartë i masës së sanksionit për biznesin, në raport me reflektimin e shkeljeve të njëjta të dispozitave ligjore, e thënë ndryshe, masa e njëjtë e sanksionit për të njëjtën shkelje ligjore në të njëjtat kushte, ndikon edhe në përmirësimin e klimës së një konkurrence të ndershme në tregun e punës. Pritshmëria jonë për këto masa merr rëndësi të veçantë tashmë, pasi ne mund të marrim të dhëna dhe vlerësim për dispozitat ligjore të shkelura më së shumti, me qëllim ndërtimin e planifikimeve të orientuara qartë për inspektimet e kryera, duke diferencuar sektorë apo aktivitete, të cilat kanë nevojë të shtuar për ndjekje.

Marrja e informacionit në kohë dhe përmbajtje nga inspektorati, mundëson përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë së vlerësimit të riskut për çdo shkelje të konstatuar të legjislacionit të punës, për të pasur objektiva të qarta në të ardhmen.

Për kërkesën specifike për ndërmarrjet e industrisë fashione, sqarojmë se të dhënat statistikore që disponon Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore janë sipas

klasifikimit të ILO-s, Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Ky sektor është i grupuar në llojin e aktivitetit si ndërmarrje prodhuese.

Ka disa problematika, që kanë dalë gjatë monitorimit specifik në fasoneri.

Gjatë vitit 2018 janë kryer 500 inspektime në aktivitetin fasoneri, ku mesatarja e punëmarrësve në këtë aktivitet rezulton me 63,2 punëmarrës për subjekt, ku 67% e punëmarrësve në këtë sektor janë femra.

Rezulton me trend rritës numri i inspektimeve të kryera në këtë sektor, siç paraqitet edhe në grafikun që e keni përpara. Duke qenë një aktivitet që punëson një numër të konsiderueshëm të punësuarish, kryesisht femra, është edhe sektori që ka gjeneruar një numër jo të vogël ankesash të adresuara për zgjidhje.

Kështu, vetëm për vitin 2018 janë trajtuar 93 ankesa, duke zënë rreth 15% të ankesave të trajtuara gjithsej për të gjithë sektorët. Arsyet e këtyre ankesave lidhen me cenimin e marrëdhënieve të punës, vonesat në dhënie e pagave, mosderdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, largimet e padrejta nga puna, si dhe për kushte pune jo të favorshme.

Vlen të theksohet se trajtimi me seriozitet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si dhe rritja e ndërgjegjësimit të punëmarrësve për të drejtat e tyre, ka bërë që 88,2% e rasteve të drejtohen drejtpërdrejt pranë nesh nga të gjitha kanalet e komunikimit të vëna në dispozicion nga ne, ndërsa 11 raste janë adresuar nga platforma e bashkëqeverisjes. Për sa i takon zgjidhjes së tyre, 74 % e tyre janë zgjidhur plotësisht dhe pjesërisht në favor të ankuesve, duke u dhënë të drejtë në pretendimet e tyre, ndërkohë që rastet e pazgjidhura janë ato që janë jashtë kompetencës sonë për trajtim apo për mungesë të fakteve, të elementeve për të identifikuar subjektin apo problematikën e pretenduar.

Nga të dhënat që disponojmë për aksidentet në punë, rezultojnë të regjistruara rastet e helmimeve të ndodhura në fasoneri, të cilat janë bërë edhe mediatike, përkatësisht, janë tri raste në qarkun e Durrësit, ku ngjarja e fundit përfshinte punëmarrës të dy subjekteve, të cilët ushtronin aktivitet në të njëjtin ambient pune, si dhe një rast në qarkun e Shkodrës, punëmarrësit e të cilëve kanë shfaqur simptoma të intoksikimit apo të alergjisë. Rastet janë shënuar në subjektin “Laoros” në qarkun e Shkodrës, me 118 punëmarrës, prej të cilëve 113 janë femra. Në datën 30.04.2018 kanë shfaqur shenja alergjie 10 punëmarrëse, të cilat punonin në një linjë të re prodhimi. Dy prej tyre u trajtuan me raport mjekësor, me diagnozë alergji, dermatit të gjeneralizuar.

Në subjektin “Lovers Albanian” në qarkun e Durrësit, me 170 punëmarrës, në datën 26.05.2018 kanë shfaqur shqetësime të përgjithshme trupore 7 punëmarrëse, që punonin në

repartin e punës në rrobaqepësi, por ende sot, edhe pas bashkëpunimit të ngushtë me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor dhe qendrat spitalore që u morën me rastin, intoksikimi është i panjohur.

Në subjektin “Denim factory” në qarkun e Durrësit, me 56 punëmarrës, 51 prej të cilëve femra, në datën 24.11.2018 janë intoksikur 2 punëmarrëse, si pasojë e rrjedhjes së gazit toksik nga tubat e kondicionerit, të çmontuar për zhvendosjen në repartin e punës.

Subjekti “Albastir”, me 40 punëmarrës të punësuar dhe “Tucci Konfektion”, me 79 punëmarrës, ushtronin aktivitetin e tyre në të njëjtin ambient pune. Në datën 29.01.2019 kanë shfaqur shqetësime shëndetësore si pasojë e rrjedhjes së tubit të gazit, kaldajës, në repartet e punës, 15 punëmarrëse, të cilat, pas marrjes së shërbimit mjekësor, kanë lënë spitalin brenda ditës. Në tri nga rastet e mësipërme është gjykuar se vijimi i procesit të punës përbënte rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve, arsye për të cilën është ndërhyrë me marrjen e masave urgjente të pezullimit të punës për të mos lejuar vijimin e saj deri në sigurimin e kushteve të qëndrueshme, që nuk cenonin më sigurinë dhe shëndetin e tyre. Rezultojnë me raport mjekësor 13 punëmarrëse të lënduara, që janë regjistruar si punëmarrëse të aksidentuara në punë dhe u trajtuan si të tilla nga skema e sigurimeve shoqërore.

Eglantina Gjermani – Zoti Seferaj, ju kërkoj ndjesë, sepse është hera e dytë që ju ndërpres, por dua që të gjithë të ftuarit të kenë mundësi të flasin, sepse kemi edhe një mbledhje tjetër në orën 13:30!

Do t’ju lutesha ta përmbyllnit fjalën me sugjerime konkrete, nëse keni, se çfarë ndihme konkrete kërkohet për t’ju ndihmuar më shumë, për të lobuar, për të monitoruar punën e qeverisë, ministrisë, për t’ju ndihmuar më shumë dhe për ta bërë punën më efikase.

Arben Seferaj – Ndihma që ne kërkojmë si inspektorat, në pamundësi për ta bërë vetë, është sensibilizimi që u duhet bërë punëmarrësve dhe punëdhënësve nëpërmjet medieve për proceset që janë tejet sensibilizuese për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Si inspektorat, mundohemi ta bëjmë vetë këtë nëpërmjet inspektimeve për ndërgjegjësim dhe këshillim, por kemi pasur të mbuluar vetëm 5% të inspektimeve në rang të të gjitha subjekteve në Republikën e Shqipërisë. Kështu që ndihma konkrete që kërkojmë në këtë rast është të na ndihmoni të gjejmë një formë, me qëllim që të lançojmë një fushatë të tillë për të dhënë rezultate konkrete. Sigurisht që ne mundohemi edhe nëpërmjet faqes zyrtare, që është e aksesueshme nga të gjithë dhe ka dhënë rezultate, por kjo është e pamjaftueshme. Nëpërmjet sindikatave... Vëmë re se në të gjitha subjektet fasoneri, roli i sindikatave është pothuajse inekzistent. Sigurisht, ne stimulojmë që sindikatat të kenë një rol, me qëllim që të arrihet në konkluzione sa më të qarta, edhe nga sindikatat, punëmarrësit, punëdhënësit, por edhe nga

Inspektorati Shtetëror, që është... Këto janë ndihmat që kërkojmë ne. Sigurisht që nuk po fokusohem te ndihma që mund të kërkojmë për rritjen e numrit të inspektorëve dhe të bazës logjistike, që lë për të dëshiruar. Po e lëmë për një moment tjetër këtë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti Seferaj!

Do t'u kërkoj të ftuarve të jenë sa më koncizë. Secili të flasë 5 minuta, që të kemi mundësi për pyetje dhe diskutime.

Vazhdojmë me zonjën Vjollca Braho nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ju lutem, 5 minuta, në mënyrë që t'ju respektoj të gjithëve. Çdo material që keni në formë të shkruar, mund ta lini në sekretari dhe nënkomisioni do të bëjë një mbledhje brenda vetes për të ecur më tej me hapat dhe sugjerimet tuaja. Kështu që, duhet të jeni koncizë.

Faleminderit!

Vjollca Braho – Faleminderit, zonja Gjermani, që na keni ftuar për të diskutuar në nënkomisionin tuaj!

Njoftimi ishte për problematikat e ndodhura në disa fasoneri në Shqipëri. Në vijim të fjalës së parafolësit, gjatë kontrolleve të kryera janë marrë disa masa. Gjatë vitit 2018 janë kontrolluar nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor 248 fasoneri në të gjitha qarqet e Shqipërisë. Në vitin 2018 është marrë një masë administrative prej 500 mijë lekësh për mungesë të akt miratimi higjieno-sanitar për fasonerinë ARTEX në Elbasan. Gjithashtu, është paralajmëruar një fasoneri në qytetin e Fierit dhe janë marrë dy vendime të ndërmjetme në Durrës: është bërë pezullimi i menjëhershëm i aktivitetit të këtyre fasonerive deri në momentin që janë kryer të gjitha analizat e nevojshme për të nxjerrë arsyet e ngjarjeve që kanë ndodhur, për të cilat jemi njohur edhe nëpërmjet medias.

Në datën 21 janar të vitit 2019 jemi njoftuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik në Durrës dhe nga spitali rajonal Durrës për problemin që ndodhi në këtë fasoneri. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor menjëherë ka marrë masat dhe ka shkuar për të kontrolluar të gjithë situatën në këtë fasoneri nëpërmjet grupeve të kontrollit. Është pezulluar i gjithë aktiviteti i kësaj fasonerie deri në datën 7 shkurt. Në këtë periudhë u shtruan disa punonjës në spitalin rajonal të Durrësit, por në bazë të kartelave që na kanë ardhur në rrugë zyrtare nga inspektorati i Durrësit, këta punonjës ishin shtruar vetëm për një ditë dhe pas marrjes së ndihmës së shpejtë nëpërmjet serumit është bërë e mundur e gjithë pjesa e procedurës mjekësore për të gjitha analizat e tyre për sa i përket oksigjenit në gjak dhe të gjitha analizave të tjera. Përgjigjja ka ardhur që nuk ka pasur probleme për sa i përket toksikimit që ka ndodhur në këto fasoneri.

Sigurisht, ndërhyrja jonë do të jetë e menjëhershme në të gjitha rastet. Pavarësisht se sipas ligjit në fuqi inspektorati e ka për detyrë që jo më shumë se brenda 7 ditëve ne duhet të bëjmë njoftimin në të gjitha subjektet që kontrollohet, unë mendoj se këtu duhet të bëhet një rishikim i ligjit. Kjo sepse nëse ne i lajmërojmë më përpara subjektet që do të kontrollojmë, mund të kemi edhe fshehje të situatës në të cilën ndodhen ato subjekte, të kushteve të tyre të punës dhe gjithçkaje që është për t'u kontrolluar. Sigurisht, duhet të kemi një vijueshmëri akoma edhe më të madhe, por si rezultat i një strukture jo të mirë që ka Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ashtu sikurse tha edhe drejtori i Inspektoratit të Punës, pasi numri i punonjësve në inspektorat është mjaft i vogël, kurse subjektet janë shumë të mëdha, nuk kemi shtrirje për të bërë të gjitha këto kontrole. Sigurisht, për vitin 2019 duhet të kemi një përmirësim të cilësisë së inspektimeve. Ne nuk do të shkojmë vetëm për të parë lejen e miratimit higjeno-sanitar dhe aktet e miratimit të tyre (gjatë këtyre viteve janë marrë 141 leje higjeno-sanitare), por duhet të bëhet një punë cilësore për të nxjerrë problemet që ne kemi.

Kur merret leja e miratimit dhe aktmiratimit higjeno-sanitar, nga pronarët e subjekteve duhet të bëhet një vetëdeklarim i situatës në të cilën ndodhen. Sigurisht, Inspektorati, në bazë të të gjitha procedurave që ka, vepron në disa fusha, duke filluar nga mjeku, kartelat e punonjësve, kushtet higjeno-sanitare, ndriçimi, dezinfektimi, kushtet në të cilat punon mjeku analizat e ujit, dezinfektimi. Pra, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka disa fusha në të cilat vepron, por sigurisht duhet të bëhet një intensifikim i mëtejshëm në të ardhmen për një punë, kontroll dhe një inspektim sa më cilësor. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor nuk ka një laborator të tijin për të bërë analizat e nevojshme, por i dërgon ato në drejtoritë rajonale, në spitalin e Durrësit, ku kanë ndodhur tre rastet, por edhe në QSUT për një analizë më të hollësishme për sa i përket toksikimit. U tha që intoksikimi i punonjësve në Durrës ka ardhur si rezultat i mostrave, por ne nuk kemi informacion pasi çështjen e ka marrë prokuroria. Janë disa çështje që do të vendosin për punën tonë në të ardhmen, në mënyrë që problematikat që kanë ndodhur të mos përsëriten më. Kështu që kërkojmë ndihmën tuaj.

Për sa i përket përcaktimit të ligjit, është bërë një punë e mirë, të gjitha inspektimet janë *online*, por edhe kjo ka problematikat e veta. Për sa i përket numrit të inspektimeve, duhet të themi që nuk kemi organikën dhe mjetet e nevojshme për të bërë inspektimet e duhura. Të gjithë punonjësit dhe grupet e inspektimit shkojnë me mjete e tyre. Ne kemi 12 rajone, por nëse shkon në Elbasan, do të shkosh në Librazhd, Gramsh, Peqin. Pra, shtrirja është

shumë e madhe. Pra, me infrastrukturën që kemi e kemi të pamundur të realizojmë objektivat kryesorë dhe sfidat që ka Ministria e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Braho, për sugjerimet për problematikat që ngritët!

Në fakt, kur ftuam grupet e interesit, menduam të kemi një larmi të përfaqësuesve nga institucionet shtetërore që e trajtojnë këtë çështje, përfaqësues nga institucione të pavarura dhe shoqëria civile për të dëgjuar perspektivat e të gjitha grupeve.

Veç faktit që e kishim shqetësim problematik, kjo edhe për ngjarjet që ju përmendët, respektimin e të drejtave të grave në tregun e punës, qeveria shqiptare dhe ne si parlament e kemi rekomandim nga Konventa Kundër të gjitha Formave të Diskriminimit respektimin e të drejtave të grave, sigurinë e tyre në punë, shëndetin e tyre. Në raportet e Komisionit Europian është theksuar në mënyrë të veçantë pjesa e sigurisë dhe respektit të të drejtave të grave në tregun e punës, sidomos në industrinë tekstile dhe fasone.

Fjalën e ka Komisioneri Kundër Diskriminimit për të paraqitur perspektivën e institucionit nëse kanë marrë ankesa të tilla, si janë trajtuar, çfarë problematike është vënë në dukje dhe çfarë për ndihme keni nevojë nga nënkomisioni. Më pas fjalën e ka shoqëria civile për të paraqitur studimet që kanë bërë dhe problematikat që kanë vënë re. Në fund do të bëjmë pyetje dhe diskutime.

Faleminderit!

Robert Gajda - Faleminderit!

Për të thënë të drejtën, nuk dua t'ju marr më shumë kohë përfaqësuesve të shoqërisë civile, të cilët janë më të specializuar dhe më në terren, por pa diskutim edhe përfaqësuesve të shtetit dhe inspektorateve në lidhje me kushtet e punës. Jam dakord që është e nevojshme një lloj fushate ndërgjegjësuese e gjithanshme.

Për sa i përket kësaj problematike, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon që punëdhënësit duhet të kenë në ambientet e tyre të punës informacione të mjaftueshme për diskriminimin apo mekanizmat që punëmarrësit duhet të kenë për të rregulluar situatat diskriminuuese. Kam përshtypjen që duhet të bëhet një fushatë informuese dhe sensibilizuese më e madhe.

Jo më shumë se para dy javëve ne kemi bërë një marrëveshje bashkëpunimi me inspektoratin. Duam shumë t'i trajtojmë bashkë çështjet që lidhen me diskriminimin dhe aspekte të tjera të punësimit. Ne kemi mangësitë tona nëse na paraqitet një çështje inspektimi dhe inspektorati mund të na japë një mënyrë më të mirë për t'i kryer inspektimet, por nga

ana tjetër edhe inspektorati evidentoi një lloj mangësie informacioni në lidhje me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Ne shikojmë që mbi 70% e punëmarrësve janë femra. Pra, ka diçka që lidhet me aspektin gjinor.

Kodi i Punës parashikon që punëmarrësi mund ta ushqejë fëmijën e tij në vendin e punës. Kur nuk i sigurohet jeta në punë vetë punëmarrësve, si do ta ushqejë fëmijën në punë kur nuk ka garanci?

Unë kam përshtypjen se Inspektorati ka nevojë për një mbështetje më të madhe. Duhet të ketë më shumë inspektorë, më shumë prezencë në territor dhe subjektet duhet të ndjejnë më shumë prezencën e shtetit, sepse shumë gjëra njerëzit nuk i bëjnë me koshiençë. Kështu që, më shumë sesa nevojë imediate nga ana e komisionerit, mendoj se duhet të kishte një suport më të madh në inspektorate, në mënyrë që të kishte një prezencë më të madhe dhe të garantoheshin ato standarde minimale për sigurinë në punë. Pra, nuk duhet kontraktuar më në standardet minimale. Duhet folur për përmirësimin sa më të madh të këtyre standardeve dhe jo për cedimin e tyre.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti Gajda!

Tani do të vazhdojmë me përfaqësues nga shoqëria civile. Gjej rastin t'ju falenderoj jo vetëm për praninë tuaj këtu, por edhe për kontributin për të trajtuar një çështje të rëndësishme. Me faktet dhe të dhënat që mblidheni na ndihmoni ne, por edhe qeverinë për të ndërtuar politika apo për të marrë masa për t'iu përgjigjur më mirë problematikave që ju ngrini.

Të gjithë ne jemi deputetë, kemi në zonat tona elektorale ndërmarrje fasone, i kemi takuar gratë dhe vajzat që punojnë aty, sepse shumica janë gra dhe vajza, të cilat i kanë ngritur shqetësimet e tyre që nga pjesa e marrjes apo jo e pagës minimale, shëndetit, sigurisë në punë, pushimeve në ditët e shtuna dhe të diela, të pagesës për oraret e zgjatura e të tjera me radhë. Kështu që, unë do të doja të dëgjoja këndvështrimin tuaj si përfaqësues të shoqërisë civile dhe nga studimet që ju keni ndërmarrë.

Fjalën e ka Mirela Arqimandriti, nga Aleanca Gjimore për Zhvillim. Faleminderit!

Mirela Arqimandriti – Përshëndetje të gjithëve!

Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, e mbështetur nga qeveria suedeze përmes *Olaf Palme International Center* është duke kontribuar prej disa vitesh për ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave punëtore në fabrikat e këpucëve dhe tekstileve në lidhje me të drejtat e tyre në marrëdhënien e punës.

Gjatë takimeve me to, ne kemi vënë re çështjet si më poshtë:

Kushtet e punës në shumë prej fabrikave të vëzhguara nga ne dhe të dëshmuara nga vetë gratë dhe vajzat punëtore janë larg standardeve të punës së denjë, sipas konventave ndërkombëtare të ILO-s dhe jo në zbatim të Kodit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Midis punëmarrësve, por edhe punë dhënësve ka një vetëdije të ulët ligjore për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, sjellje dhe qëndrime të gabuara, në disa raste mungesë informacioni dhe njohurish. Këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë, që duhen krijuar sipas ligjit, janë ndërtuar sa për të ekzistuar në letra. Anëtarët e tyre në shumicën e rasteve janë persona të afërt me familjen e pronarëve dhe nuk marrin asnjë masë konkrete për të përmirësuar kushtet e punës. Mjeku i ndërmarrjes, gjithashtu, është një pozicion sa për të qenë në letër. Punëmarrësit janë të dekurajuar të ngrenë zërin për kushte më të mira për shkak të nivelit të lartë të papunësisë dhe dhunës verbale, ekonomike dhe në disa raste edhe fizike të ushtruar brenda ndërmarrjeve. Në asnjë ndërmarrje që ne vëzhguam nuk ekzistojnë mekanizma stimulues për punonjësit që zbatonin rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në Shqipëri nuk janë hartuar nga institucionet përkatëse qeveritare udhëzues për zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Konsultimi dhe përfshirja e punonjësve në çështjet e sigurisë dhe shëndetit, është në nivelin zero. Ka dyshime të forta që shumica e aksidenteve në punë nuk raportohen fare. Ka shumë raste të raportuara kur kanë qenë masive, që ju sapo e përmendët, por ka edhe të paraportuara të gjendjes të të fiktit që na i thonë vetë gratë.

Bazuar në artikuj shkencor, kjo ndodh, sepse materiale e tekstileve shpërthejnë në ajër për shkak të bojërave të përdorura me elemente të ndryshme helmuese. Këto raste janë të pa trajtuara dhe nuk marrin parasysh dëmet që sjellin në tru me kalimin e viteve pas gjendej të të fiktit.

Përveç kësaj, industria e modës është një nga industritë më ndotëse të planetit. Sipas Bankës Botërore, 20% e ndotjes globale është shkaktuar nga përpunimi i tekstilit. Këtu tek ne nuk është marrë asnjë masë për t'u parë ujërat e lumenjve apo përrenjve ku derdhen të gjitha këto solucione, përfshirë edhe mastiçin e ngjitjes së këpucëve.

Kam një material me shkrim, ku flitet për konventat ndërkombëtare, Kodin e Punës dhe ligjin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe po e lë.

Dita e shtunë është kthyer në një ditë rutinë pune. 95% e punonjësve janë gra, të cilat nuk përfitojnë pushim të paguar as në rast sëmundje apo kujdesi për fëmijët. Shumë gra dhe vajza shqiptare punojnë në të zezë, pra, nuk ju paguhen sigurimet shoqërore. Ne kemi pasur disa raste të sigurimeve shoqërore kur gratë e moshuara duan të marrin pensionin dhe shikojnë

që nuk u janë paguar sigurimet shoqërore për një periudhë kohe, pavarësisht se ato kujtonin se ishin në marrëdhënie pune të rregullta. Kontratat kolektive ato pothuajse nuk i shikojnë kurrë.

Nga qeveria shqiptare, e cila është përgjegjësjë kryesore për krijimin e një qasjeje të harmonizuar për zbatueshmërinë e legjislacionit dhe garantimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, dua të merren masa për garantimin e zbatimit të Kodit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, zbatimin e dokumentit politik 2016-2020 për sigurinë dhe shëndetin në punë, promovimin e kulturës së parandalimit të tolerancës zero në punësimin e fëmijëve. Vetë gratë na kanë thënë që në stinën e verës kanë pasur edhe fëmijët nga 13-14 vjeç në punë, për shkak se nuk e mbajnë dot familjen.

Duhet të garantojnë konsultimin dhe informimin e punëmarrësve nga punëdhënësi në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë. Kurse nga ju si nënkomision ne kërkojmë që t'i kërkonit Institutit të Statistikës hartimin e të dhënave të sakta në lidhje me numrin e fabrikave të tekstileve dhe këpucëve, shpërndarjes e tyre dhe numrin e punonjësve në fabrikat e tekstileve dhe këpucëve në Shqipëri, sepse ju përmendët që sipas një konvente të ILO-s këto quhen ndërmarrje prodhuese dhe nuk ka një ndarje të saktë të këtyre si për fabrikat, ashtu edhe për numrin e njerëzve.

Qeveria shqiptare duhet të mbulojë me sa më shumë inspektorë territorin e Shqipërisë dhe të vërë në përdorim inspektimin *online*.

Inspektorati i punës, sipas ligjit, ka të drejtë të inspektojë pa paralajmërim. Mund të vendoset një sistem raportimi tërësisht anonim, gjë që ju e keni bërë, por problemi më i madh është që gratë nuk dinë ta përdorin *website*-n. Ndaj duhet të gjejmë një mekanizëm tjetër. Ne si organizatë kemi hapur një numër jeshil falas 0800 18 18 dhe po e promovojmë gjerësisht. Së bashku me Komisionerin dhe Inspektoratin e Punës kemi bërë një poster të madh të përbashkët, të cilin do ta ngjisim në të gjitha ndërmarrjet e tekstileve dhe këpucëve, që mund të jetë një mjet promovues, siç u tha këtu, i të drejtave të këtyre njerëzve, sepse zakonisht ato dinë vetëm detyrime.

Duam që të hartohet një VKM e posaçme për shëndetin dhe sigurinë në punë në industrinë e tekstileve dhe të këpucëve. Dimë se ka disa VKM të tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me punën që bëhet aty, por në kushtet kur praktika tregon mungesë zbatimi të ligjit ne duam një rregullim të posaçëm për këtë gjë.

Kompanitë e huaja në Shqipëri, doganat dhe Ministria e Ekonomisë duhet të identifikojnë brendet e huaja që hyjnë në Shqipëri, sepse ne e dimë që këtu prodhohet për brandet e huaja, por etiketa ju vihet në Itali për t'u rritur çmimin dhe nuk quhet *Made in Albania*. Të paktën të njihet që prodhohet në Shqipëri.

Duhet të bëhet njohja e pagës minimale jetësore në Shqipëri dhe llogaritja e saj, sepse jemi ndër vendet që nuk e kemi këtë lloj llogaritje.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit për punën që keni bërë dhe të dhënat që ndatë me ne! Në fakt, janë shumë shqetësuese dhe rikonfirmojnë faktin pse e kemi vënë në planin e punës këtë seancë dëgjimore. Besoj se të gjithë kolegët kanë pyetje, por unë po vazhdoj përsëri t’u jap mundësi edhe kolegëve të tjerë për të folur.

Vazhdojmë me zotin Edison Hoxha, nga Qendra për të Drejtat e Punëtorëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk thashë që jeni shoqëri civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju jeni kategori më vete. Nuk mund t’ju fusja te qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do ju dëgjojmë, por sipas kësaj renditjeje që kanë konfirmuar. Ky është nënkomisioni më tolerant nga të tjerët dhe duhet të mirëkuptohet më mirë se të tjerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edison Hoxha – Përshëndetje!

Faleminderit për ftesën!

Në vazhdim të gjërave që theksoi Mirela unë po vazhdoj me rekomandimet që ne kemi si qendër.

Rekomandimi i parë është që Këshilli i Ministrave dhe ministritë e linjës të plotësojnë kuadrin nënligjor dhe atë institucional për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mjekësinë e punës.

Po të kemi parasysh, ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë ka hyrë në fuqi në vitin 2010. Bazuar në këtë ligj, duhet që brenda 6 muajve të plotësoheshin të gjitha vendimet specifike të Këshillit të Ministrave. Vitet e fundit është bërë një punë e mirë, duke filluar nga viti 2012, me një projekt të mbështetur nga Bashkimi Europian, por gjithsesi ky proces akoma nuk është përfunduar. Ne kërkojmë që ky proces të përfundojë sa më parë. Jemi në vitin 2019, duhet të bëhej brenda 6 muajve, kemi 9 vjet dhe nuk e kemi përfunduar.

Kjo lidhet me të gjitha çështjet që sqarova, janë implementime dhe transpuzion direktivash të Bashkimit Europian. Gjithsesi, nuk do të merren shabllon, por janë me disa specifika që duhen plotësuar. Ky është rekomandimi i parë.

E dyta, është vënia në eficiencë e Këshillit Ndërmintor për Sigurinë e Shëndetit në Punë, që, edhe pse ligji e parashikon, nuk ka funksionuar ndonjëherë. Ligji për sigurinë e

shëndetit në punë ka Këshillin Ndërministror, për të cilin mendojmë se duhet të vihet në eficiencë.

E treta, institucionet kompetente, si Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore, Inspektorati Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Policia e Shtetit duhet të rrisin koordinimin dhe bashkëpunimin për të siguruar përmbushjen e duhur të standardeve të punës nga ana e punëdhënësit dhe më pas sanksionimin në mënyrë të arsyeshme në rast se gjenden shkelje.

Nga fjalimi që u bë nga dy inspektoratët që janë prezent, duket që mungon koordinimi midis tyre. Ne kërkojmë që koordinimi dhe bashkëpunimi të shtrihet edhe në institucionet e tjera.

Sigurimet Shoqërore kanë institutin përkatës dhe kanë një rol shumë të rëndësishëm. Po ashtu, edhe Policia e Shtetit ka rolin e vet, sepse, rastet e aksidenteve në punë, siç kanë ndodhur, fatkeqësisht, kohët e fundit, janë vepër penale. Këtu hyn edhe roli i Policisë së Shtetit dhe më pas i instancave, prokurorisë apo gjykatës.

Sugjerimi tjetër është që Inspektorati Qendror, Inspektorati i Punës dhe sidomos Inspektorati Shëndetësor të punojnë në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe etike të inspektorëve të punës. Inspektorati i Punës, mes vështirësive, ka bërë një punë, gjendet në terren, por Inspektorati Shtetëror është në nivele zero për ne, nuk gjendet gjëkund, nuk e shikojmë. Ndoshta kryeinspektorja është e re në këtë detyrë dhe nuk po flasim konkretisht, por inspektorati duhet të ketë një rol shumë aktiv në çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Nga kontaktet që kemi pasur ne, shumë inspektorë shëndetësorë nuk e dinë fare që e kanë pasur këtë detyrë ose e dinë sikur e kanë si pikë në ligj, por pa rëndësi.

Një ndërhyrje tjetër, që unë mendoj se duhet të adresohet, është çështja problematike e këshillave të sigurisë dhe shëndetit në punë, funksionimit të tyre. Të gjithë themi, biem dakord dhe konstatojmë se këto janë fiktive, bëhen nga punëdhënësi, por nuk funksionojnë siç duhet, nuk janë eficiente. A mund të ndërhyjmë ne sot në ligj? Këtë po e them për herë të parë këtu sot, në fakt, sepse këtu e mendova si mundësi. Mund ta zvogëlojmë ne rolin që ka punëdhënësi në funksionimin apo krijimin e këshillave? Mund t'i japim një rol më të madh Inspektoratit të Punës, për shembull? A mund të ketë një rol tjetër? Pra, t'ia heqim këtë autoritet absolut punëdhënësit për krijimin e këshillave dhe t'ia kalojmë inspektoratit? Të gjejmë një modalitet në ligj, që ta ndryshojmë ligjin për këtë pjesë. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse ndryshe nuk do të funksionojë asnjëherë, do të ngelemi këtu, do të themi se janë formale, nuk funksionojnë, por do të përpiqemi t'i rregullojmë. Prandaj mendoj se edhe kjo çështje është shumë e rëndësishme.

Pikë tjetër, që ne e mendojmë të rëndësishme dhe duhet adresuar, është rritja e numrit dhe frekuencës së kontrollit të inspektimeve nga ana e institucioneve përgjegjëse të monitorimit të ligjit të punës, Inspektorati i Punës si më kryesori, por edhe inspektorateve të tjera, duke përfshirë grupe të integruara në këto monitorime, edhe punëmarrësit, edhe sindikatat, atje ku funksionojnë, sepse mund të kemi raste ku funksionojnë, nuk mund të paragjykojmë çdo ndërmarrje, pavarësisht problematikave për këtë çështje, që inspektimi të mos jetë vetëm i jashtëm. Ne kemi parë që punëmarrësit nuk dinë gjë nëse është bërë ndonjë inspektim aty apo jo dhe si bëhet.

Një hulumtim më i gjerë dhe i thellë i forcës punëtore duhet të jetë pjesë integrale dhe e rëndësishme e inspektimeve të punës, duke synuar në mënyrë periodike marrjen e informacionit përmes anketimit të fuqisë punëtore nga vetë institucionet monitoruese të ligjit. Pra, duhet të monitorohet vetë fuqia punëtore nga inspektoratet, nga institucionet ligjzbatuese të punës.

E theksova edhe pak më parë, që detyrë imediate është vënia në eficiencë e Inspektoratit Shëndetësor, e mjekësisë së punës. Kjo është shumë e rëndësishme.

Gjithashtu, nxitja e aksionit kolektiv dhe mbrojtja kolektive e punëmarrësve përmes funksionimit real të sindikatave brenda këtij sektori, duke mbështetur kontraktimin kolektiv në nivel kombëtar është një çështje, që nuk e di sa mund të adresohet vetëm specifikisht për këtë, por unë mendoj se është shumë e rëndësishme, sepse është çështja e pagës, çështje të tjera që nuk rregullohen drejtpërdrejt nga ligji, por negociohen dhe nëse nuk ke një kontraktim kolektiv efektiv, gjithmonë këto do të jetë atribut i punëdhënësit, sepse punëmarrësi nuk mund të jetë aq i fuqishëm sa duhet individualisht në raport me punëdhënësit.

Nxitja e dialogut social në nivel sektori fason është një pikë shumë e rëndësishme, që mendoj se duhet thënë. Duhet të ishte shumë e rëndësishme të adresohet.

Këto sugjerime kisha.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Do t'ia jap fjalën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të vazhdojmë kështu, sepse kemi të gjithë shumë pyetje dhe komente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vjollca, të lutem!

Unë nuk të kam dhënë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të vazhdojmë me zonjën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka mundësi të respektojmë rregullat këtu? Të gjithë kemi pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdojmë me zonjën Frosina Gjino, Qendra për Sigurinë Dhe Shëndetin.

Frosina Gjino – Qendra Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është e financuar nga Bashkimi Europian.

Eglantina Gjermani – Ju lutem, shkurtimisht!

Faleminderit!

Frosina Gjino – Vetëm në nivel profesional.

Ne po flasim për zbatimin e ligjit të sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili në themel të tij ka ekspertët e sigurisë dhe të shëndetit në punë. Ende edhe sot, po të shkoni në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të thoni se do të licensoheni si ekspert i sigurisë dhe shëndetit në punë, ata nuk e njohin si profesion. Si mund të zbatohet një ligj kur nuk ka ekspertë të sigurisë dhe shëndetit në punë? Në të gjithë botën ka. Edhe Maqedonia ka universitet. Ne nuk kemi as trajnim të tyre, ndaj është imediate trajnimi, formimi dhe licencimi i ekspertëve të sigurisë dhe shëndetit në punë, sepse siguria dhe shëndeti në punë kërkojnë sistemet e menaxhimit, që janë standarde shkencore, nuk mund të bëhen me lojë fjalësh.

Janë dy themele: e para, përgatitja e ekspertëve dhe ngritja e sistemeve të menaxhimit dhe, e dyta, përfshirja e punëmarrësve në çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Është urgjente. Ne kemi diskutuar edhe me zotin Arben dhe kjo duhet të bëhet sa më parë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Me aq zë të lartë, na trembe. Apo keni dëgjuar se në parlament vetëm bërtitet? Jo, edhe në parlament bëhet bisedë normale.

Faleminderit!

Ishte shumë me vlerë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E shikoj. Kështu të mbaj mend gjithmonë.

Vazhdojmë me zonjën Pleada Gugashi nga *Olam Fam International*.

Shkurtimisht, ju lutem!

Faleminderit!

Pleada Gugashi – Mirëdita!

Ne si organizatë suedeze mbështesim sindikatat dhe shoqërinë civile për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave në punë dhe nuk punojmë drejtpërdrejt në terren. Janë organizatat dhe partnerët tanë, të cilët marrin informacione nga terreni dhe shfaqin rekomandime.

Unë nuk dua të përsëris çfarë u tha deri tani, sepse jam dakord me pjesën më të madhe të tyre, por një gjë që vërej është se duhet të ketë një presion më të madh ndaj autoriteteve shtetërore si garantuese kryesore të zbatueshmërisë së standardeve në punë, sepse shpeshherë merren masa pasi ka ndodhur veprimi. Kur ndodhin aksidente, vihen në lëvizje institucionet shtetërore. Theksi duhet të vihet zakonisht te masat parandaluese dhe këtu u përmendën shumë këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë, që janë absolutisht jofunksionale. Është një mekanizëm ligjor që duhet të jetë i detyrueshëm dhe i zbatueshëm për të gjitha kompanitë që kanë mbi 50 persona të punësuar. Nga monitorimi që ne kemi bërë, këta këshilla janë inekzistente dhe duhet të ketë një rol primar inspektorati në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile dhe sindikatat që bashkëpunojnë për t'i bërë këta këshilla sa më efektive dhe funksionale, përndryshe do të ndodhin aksidente dhe ne nuk do të mund t'i parandalojmë në kohën e duhur. Patjetër që theksi duhet të vihet te parandalimi i çështjeve të sigurisë dhe shëndetit.

Ndërkohë, të paktën nga monitorimi që është bërë vihet re se inspektorët e punës, në momentin që kryejnë inspektimin, e bëjnë shumë formalisht. Ata shkojnë atje, marrin një listë dokumentesh që ua ofron punëdhënësi dhe supozohet që e kanë kryer misionin e tyre. Është shumë e rëndësishme të rritet cilësia dhe efektiviteti i këtyre inspektimeve. Ndoshta në këtë rast mund të ishte me vend të ngriheshin grupe të integruara inspektimi, që u tha më parë. Në përbërjen e tyre mund të ketë përfaqësues nga Inspektorati i Punës, përfaqësues nga sindikatat apo nga organizmat e tjerë të shoqërisë civile që merren me çështjet e të drejtave në punë dhe të drejtave të njeriut.

Së fundi, unë jam e sigurt që rekomandimet që jepen këtu nuk janë shteruese. Patjetër që do të ketë rekomandime nga konfederata dhe nga sindikata të tjera.

Mendoj se është e rëndësishme të hartohet një plan veprimi i përbashkët ndërinstytucional fillimisht, por edhe jashtë institucioneve në bashkëpunim me sindikatat dhe aktorët e shoqërisë civile, se çfarë hapash dhe masash duhet të merren në bazë të rekomandimeve që ne po japim në këtë fazë. Mendoj se duhet të jetë një presion që bëhet nga komisioni juaj karshi autoriteteve shtetërore për t'i ulur bashkërisht institucionet shtetërore, shoqëritë civile, sindikata, për të hartuar plane veprimi dhe për të adresuar këto çështje që vazhdojnë të mbeten problematike, për fat të keq.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit për praninë, kontributin dhe ndihmën që u jepni organizatave për të trajtuar një problem kaq të rëndësishëm.

Vazhdojmë me përfaqësuesit e Konfederatës së Sindikatave, me presidentin, zotin Kolë Nikolli.

Besoj se i dëgjuat të dyja palët dhe si përfaqësues i Konfederatës do të keni një pamje më të gjerë.

Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur.

Kolë Nikolla – Ne nuk jemi për të gjykuar palët.

Eglantina Gjermani – Jo, nuk thashë “gjykim”, por i keni dëgjuar.

Kolë Nikolla – Ne jemi pjesë e palëve, por kemi identitet.

Eglantina Gjermani – I keni dëgjuar dhe do të jepni perspektivën tuaj.

Kolë Nikolla – Do të më vinte keq që zonja Hysi të largohej, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta filloj nga fundi, atëherë.

Meseleja e këtij problemi është se vërtet nuk ka sindikata në këtë sektor, si në shumë sektorë të tjerë, që sindikatat janë jo prezente, të dobëta, me probleme, sepse jemi i vetmi vend në Europë, të mos them edhe më tej, që nuk ka ligj për sindikatat. Edisoni e di shumë mirë, sepse kemi qenë bashkëpunëtor për vite me radhë. I vetmi treg që nuk ka ligj, as si organizohet, as si funksionon, as si kontrollohet, as si nënshkruan, as nuk ulet në bisedime, as në tavolinë. Për aq kohë sa në Shqipëri të mos ketë një ligj për sindikatat, për kontraktimin kolektiv, zgjedhjen paqësore të mosmarrëveshjeve dhe votimin sindikal... Në Shqipëri askush nuk e di, të gjithë punonjësit thonë jam i sindikatës së Kolë Nikollës apo i sindikatës së Gëzim Kalasë. Ne kemi vetëm gratë dhe dy fëmijët tanë. Për aq kohë sa në Shqipëri nuk ka një ligj, ky problem nuk do të zgjidhet. Besoj se fillon këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht, sepse edhe pronat duhet t’i rregullojë ligji. Ndaj po e kërkojmë ligjin, për pronat, për transparencën, për organizimin, për funksionimin, për debatin, për dialogun, për kontraktimin, për të gjitha. Për aq kohë sa qeverisë së tanishme apo qeverisë së kaluar i leverdis të mos ketë sindikata, nuk bëjnë ligj që të ketë sindikata. Nëse bëhet ligji, do të ketë sindikata.

Për sa i përket problemit në fjalë, nuk do të bie në përsëritje, por do të jap dy-tri sugjerime, së pari, për mjekësinë e punës. Jo vetëm në fasoneri, por në të gjithë sistemin e punëmarrjes, nuk ekziston në Shqipëri mjekësi pune, as si kurikul universitare, as si klinikë, as si mjekë, përveç dy-tri mjekëve të specializuar në Angli, që marrim ndonjëherë kontakt formal. Në ligj thuhet se duhet të ketë mjekë pune. Vizitat periodike nuk kryhen dhe mjekët janë të përgjithshëm pa formimin e duhur, pa dokumentacionin e duhur. Më pas kanë probleme me sigurimet shoqërore, sepse sëmundjet profesionale nuk trajtohen nga mjekët profesionistë, por shkojnë nëpër klinika, në mjekë familjesh e me radhë dhe nuk përfitojnë as sigurime shëndetësore në përputhje me sëmundjen profesionale që kanë. Këshillat e sigurisë dhe

shëndetit në punë janë thembra e Akilit për të rakorduar të gjithë aktivitetin mes të gjithë aktorëve. Unë mund të them tre, por bëhen katër, pesë e me radhë.

Normalisht, ligji është me standarde europiane, i bërë që në vitin 2010 dhe ndoshta ndërhyrja në ligj, siç thotë Edisoni, është pak e vështirë, por jo e pamundur. Edhe nëse nuk hyn në ligj, nëse do të ketë dëshirën e mirë të strukturave ligjzbatuese të shtetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk kam problem, kam mbaruar,.

Kisha merak për ligjin e sindikatave, për të tjerat nuk ka problem.

Nëse do të ketë dëshirën e mirë ligjërja dhe ligjzbatimi për ngritjen dhe funksionimin e këshillave të sigurisë në punë, normalisht ata kanë një rol të pazëvendësueshëm, të jashtëzakonshëm. Realisht janë shumë formalë në disa kompani publike, në disa ndërmarrje të mëdha, janë thjesht të deleguarit e punëdhënësit ose ndonjë që ka futur sindikata në mënyrë të tërthortë, por vitet e fundit as këtë nuk kemi mundur të realizojmë.

Që të mos përsëris gjërat, probleme të tjera janë rakordimi me struktura shtetërore. Ne kryqëzojmë dy inspektorate, sepse i kemi këtu dhe tradicionalisht jemi mësuar se nëse ka probleme me sigurinë, e ka Inspektorati i Punës. Fatkeqësisht janë shumë agjenci ligjzbatuese, duke filluar që nga Shërbimi Informativ Kombëtar. Edhe për helmimin në shkallë të gjerë i punëtorëve, jo rasti i Durrësit, por në përgjithësi, të atyre me **fenolential**, punojnë me mastiç, punojnë me ngjyrosje bluxhinsesh, me përpunim lëkure, me përpunim peshku e të tjera, besoj se Shërbimi Informativ Kombëtar ka fushë për të survejuar edhe këtu, për të mos folur për policinë, për gjykatën, prokurorinë e me radhë.

Bashkohem edhe me shqetësimin e bashkëpunëtores sonë. Normalisht ne jemi vend që nuk kemi certifikuar ekspertë për shëndetin në punë dhe mjekë pune. Besoj se ky do të jetë një fillim.

Ju bëj thirrje edhe një herë, juve që jeni në parlament, që siguria dhe shëndeti në punë, jo për gratë që janë tepër shqetësuese, që punojnë në fasoneri, por për të gjithë punëtorët shqiptarë janë një kabanë alarmi dhe nëse shoqëria nuk do të kthehet të vënë dorë për këtë problem, nesër do të jetë vonë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zoti Nikolla, edhe për praninë, edhe për gjithçka që ndatë me ne për problematikat e punës suaj! Them se do të vazhdojë një proces bashkëpunimi me të gjithë aktorët, edhe pas kësaj mbledhjeje për të adresuar të gjitha problematikat që u ngritën këtu nga ne apo nga institucionet përkatëse.

Ka të pranishëm edhe nga Sindikata e Posttelekomunikacionit, apo jo?

Renato Muçaj – Dakord.

Po e nis me një batutë që tha Kola, që ne nuk jemi as të Kolës, as të Gëzimit, por jemi më vete.

Shkurt, vetëm për këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë, personalisht kam pasur një eksperiencë, sepse kam qenë kryetar i Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në kompaninë “Albtelekom”, por duke qenë se fokusi është te fasonët, besoj se është shumë e rëndësishme që të ngrihen këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Vetëm kjo e garanton zbatimin e ligjit. Ju si ligjvënës ndoshta mund të bëni një ndërhyrje që t’u jepni një status punonjësve që janë te këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë, që të jenë të mbrojtur dhe të mos u cenohet vendi i punës. Kam një pyetje: kush punonjës shkon dhe e denoncon kompaninë e vet në inspektorat? Asnjë, sepse të gjithë kanë frikë. Nëse ne i japim një status, që në mandatin 2-vjeçar të mos pushohet nga puna. Madje, edhe një vit më pas, që të mos preket, sepse mund të ndodhë një ngjarje në fundin e mandatit dhe ai preket pasi t’i mbarojë mandati. Kjo do të ishte një klauzolë që mund të ndihmonte në zbatimin e tyre. Ligji është shumë i mirë, por kam një këshillë për Inspektoratin e Punës, që në momentin që bëhen inspektimet, të mos bëhen formalisht, sepse më ka rastisur të jem në disa trajnime në sektorin *call-center* për ngritjen e këshillave dhe ata thoshin se ne e kemi këshillin e sigurisë dhe shëndetit në punë, por askush nuk i dinte anëtarët. Pra, në momentin që vjen Inspektorati, mund të marrë edhe kontakt me anëtarët e zgjedhur të këtyre këshillave. Kjo do të ishte diçka e mirë.

Mungon edhe një element tjetër, të cilin e preku Frosina, që mungojnë ekspertët dhe nuk hartohet vlerësimi i riskut. Pra, çdo kompani, nëse do të bënte vlerësimin e riskut për vendet e punës, ndoshta mund të anashkalojnë aksidentet në punë dhe të marrin masat që duheshin.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit të gjithëve, edhe për faktin që ju ngushtova në kohë, por kjo u bë për shkak të ngarkesës!

Kemi edhe pak minuta për pyetje dhe diskutime.

Zonja Dhima, fjala për ju.

Më falni, por meqenëse nuk kemi shumë kohë, të bëjmë pyetje dhe diskutime bashkë, sepse mund të bënim pyetje, por kam hallin e respektimit të kohës.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të gjithë të pranishmëve që morën pjesë në këtë seancë dëgjimore për një problem shumë të rëndësishëm për sigurinë dhe shëndetin në punë!

Kam disa pyetje.

E para, për kryeinspektorin Seferaj.

Në bazë të statistikave që ju keni si institucion, si ka ardhur numri i shkeljeve nga viti në vit në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe në drejtim të shkeljes së disiplinës së Kodit të Punës?

E dyta, edhe në fjalën tuaj, edhe në fjalën e disa të pranishmëve, u ngrit si shqetësim koordinimi ndërmjet institucioneve që janë të përfshira në zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, në drejtim të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Policisë së Shtetit. Ku konsiston ky koordinim? Çfarë kërkoni ju konkretisht? Është vetëm dhe thjesht në shkëmbimin e informacionit dhe çfarë mbështetje kërkoni ju si inspektorat nga Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas?

Për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zotin Gajda: a ka pasur raste të raportuara për shkelje të ligjit pranë institucionit tuaj nga persona që janë të punësuar në masoneri dhe të kujt kategorie janë këto raste të denoncuara ose të raportuara nga ana e personave që punojnë në këto fasoneri.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Ju lutem, mbani shënim pyetjet, që t'i japim fjalën kolegëve, dhe në fund shkurtimisht ju do të përgjigjeni.

Dakord?

Fjala për zonjën Pampuri.

Orjola Pampuri – Unë do ta nis fjalën nga denoncimi i zonjës që tha për të ngritur një grup monitorues për cilësinë dhe efektivitetin e inspektimeve.

Unë nuk dua të jem e njëanshme, sepse, sikurse u tha, është një komision ku diskutohet dhe debatohet, por është në të mirë të një grupi; i interesi, që këtu janë kryesisht gra.

Cilësia dhe efektiviteti i inspektimeve. Nga të gjitha informacionet që kam është vënë re që inspektimet ose inspektorët që funksionojnë në fasoneri apo në fabrika të tilla janë paksa të njëanshme dhe me keqardhje e them, sepse këtu është edhe zonja drejtuese e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, që inspektorë të tillë, edhe pse pak, gjëmën e bëjnë të madhe, janë shndërruar në gjobëvënës selektivë, të cilët selektojnë fabrika të lidhura me pushtetin, ku bëjnë një sy qorr dhe një vesh shurdh dhe në fabrika që nuk kanë lidhje me pushtetin, ndoshta edhe në mënyrë të padrejtë. Unë jam paksa skeptike që do të ketë efektivitet, sepse grupi monitorues do të jenë sërish këta individë. Unë them se si do të ishte idealja, por idealja në realitetin që ne jetojmë nuk mund të ekzistojë.

Drejtoresha e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor përmendi një laborator. Sigurisht është i domosdoshëm laborator, por sot kemi një shumë prej 13,4 milionë eurosh të shpenzuara

nga taksapaguesit për personat që janë larguar nga puna, zonjë, dhe këto paguhen për personat që janë larguar padrejtësisht për të punësuar militantët e “Rilindjes”. E gjitha kjo është një problematikë. Ne po diskutojmë një problematikë vërtet shumë të rëndësishme. Të gjitha të dhënat ishin interesante, por problemi fillon nga koka. Pra nuk mund ta zgjidhim dot, sepse kokën e kemi problem shumë të madh. Këtë e them me bindje, kjo është e referuar edhe nga punonjës.

Ju përmendët që është vendosur një tabelë për të drejtat e grave në punë, cila prej atyre grave nuk i di të drejtat? Një pjesë e mirë e tyre e dinë.

Janë 40 mijë gra të punësuar në fabrikat fasone; janë 40 mijë gra të cilat jetojnë në hall; janë 40 mijë gra që punojnë për të mbijetuar në ato fabrika dhe ndonjëherë në kushte skandaloze. Pra, cila prej atyre grave nuk i di të drejtat e tyre? Një pjesë e mirë e tyre i dinë, por kanë frikë t’i referojnë, sepse puna aty është e vetmja mundësi që kanë. Ndonjëherë pranojnë edhe të helmohen, si në rastin e Durrësit, por heshtin për shkak se kanë frikë.

Unë ju këshilloj të mos heshtni, pavarësisht vështirëve që keni, edhe pse kokën që na qeverisë e kemi me probleme, nga i cili fillojnë të gjitha problematikat.

Inspektorët janë shndërruar në gjobëvënës selektivë, duke filluar që nga inspektorët e tatimeve dhe deri tek inspektorët shëndetësorë, të cilët selektojnë fabrikat dhe lokalet dhe ata që nuk janë të lidhur me rilindjen u bien kokës, duke ua shkundur kokën qytetarëve dhe bizneseve.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit zonja Pampuri!

Fjalën e ka zonja Hoxha.

Elona Hoxha – Faleminderit, zonja Gjermeni!

Në radhë të parë dua të falënderoj të gjithë aktorët kryesorë që kanë ardhur sot. Në komisionet parlamentare formate të tilla rrallë herë janë të pranishëm dhe kjo është në favorin tonë si ligjberës, për të kuptuar më mirë problematikat dhe për të folur hapur. Kjo tryezë mendoj që ia vlen për mënyrën e debatit konstruktiv që ne bëjmë.

Ne mësuam për shumë gjëra dhe problematika, por dua që fjalën time ta filloj me një falënderim për zotin Sevaj dhe drejtoreshën e re të Inspektoratit, sepse nuk është kollaj që të punohet me problematika të mbartura dhe me të gjithë vështirësitë që ka realiteti shqiptar. Unë kam shumë besim se ata, me gjithë eksperiencat që kanë pasur në punët e mëparshme si menaxher të suksesshëm, do të arrijnë të ngrenë akoma më lart cilësinë dhe punën e institucioneve që ata drejtojnë dhe mendoj që i kanë të gjitha kapacitetet për këtë qëllim. Por

është e vyer edhe mbështetja e shoqërisë civile, e sindikatave dhe e Olaf Palme, për të adresuar problematikat.

Edhe unë si deputete kam një zonë të caktuar në qarkun e Tiranës, ku ka disa fasoneri, të cilat unë i kam vizituar dhe këtu ka fasoneri që janë model, sepse nuk duhet ta nxijmë këtë punë. Patjetër që ka problematika, por unë nuk kam parë ndonjë hezitim të madh nga gratë për të folur për problemet, përkundrazi ua thonë në sy pronarëve. Kjo tregon edhe mënyrën sesi ne mund t'i rregullojmë gjërat, prandaj do të jem e kujdesshme në zonën që unë përfaqësoj. Por edhe gjërat që u ngritën këtu mendoj se duhen adresuar. Nëse vërtet nuk janë ngritur këshillat për sigurinë, atëherë kjo është një gjë që mund ta bëjmë.

Çfarëdo mbështetje që do të kërkonte nga nënkomisioni dhe parlamenti, ne jemi të gatshëm. Ndoshta do të duhet të bëhen disa aktivitete, këtë duhet ta mendoj kryetarja, nuk po themi monitoruese, por ndërgjegjsuese, ku prezenca e deputetëve do të jetë më e pranishme.

Kuptoj që ka nevojë për një koordinim më të mirë, por unë jam shumë optimiste që drejtuesit kryesorë në bashkëpunim me shoqërinë civile do t'i adresojnë të gjitha këto probleme dhe neve na ngelet të shohim se si do të adresohen këto probleme, por kryesore mendoj që është ngritja e këshillave të sigurisë.

Për sa u përket mjekëve, ne kemi mjekë dhe nuk mendoj që duhet të vijnë nga jashtë, sepse ne kemi edhe një departament në QSUT për sëmundjet profesionale, që mund të ofrojnë edhe trajnime të specializuara për mjekët që kanë nevojë. Kjo është e mundur dhe inkurajoj mjekët që të jenë të ingranuar në organogramë, që të jenë efektivë, sepse zëri i tyre ka një vlerë.

Nuk kam dëgjuar shumë për rolin që kanë punonjësit e shëndetësisë dhe se si ata mund të fuqizohen më shumë, por besoj se kolegja ime Klodiana do ta shpjegojë më mirë rolin e tyre.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Hoxha!

Zonja Spahiu fjala për ju.

Kolë Nikolla – A mund të bëj një ndërhyrje vetëm 30 sekonda që ta përforcoj?

Kam dëgjuar dje në medie për një konferencë që është bërë nga shoqëria civile, ku është diskutuar për të larguarit nga puna, por edhe për pagesat që bëhen nga buxheti i shtetit. Nga studime profesionale që ka organizuar sindikata jonë, jo sot, por ka 9 vjet që e ndjek këtë problem dhe ka katër zyra ligjore, rezulton që janë paguar rreth 9 milionë euro për të larguarit nga puna që para vitit 2013. Përpara ishte një vendim i përbashkët i ish-ministrave Ksera dhe Bode, që të larguarit nga puna të kompensohen për 28 vjet. Ai vendim u shfuqizua dhe buxheti i shtetit u detyrua të paguaj.

Në vitin 2013, me ndërrimin e pushteteve, Ministria Mjedisit ka larguar nga puna për një natë 460 punonjës, të cilët i kanë fituar gjyqet dhe vazhdon likuidimi i tyre nga buxheti i shtetit. Largimet e tjera janë bërë nga pushteti vendor, Ministria e Drejtësisë dhe nga Policia e Shtetit. Kjo ka të bëjë me qeverinë e famshme të tranzicionit, të zgjedhjeve të kaluara, e cila u bë me një marrëveshje, ku ministrat e rinj dhe të dubluar larguan njerëzit.

Englantina Gjermani – Më thatë 30 sekonda dhe unë ju respektova.

Kolë Nikolla – Dua të them që largimet janë bërë katër vjetët e kaluar, ndërsa tani me vendosjen e statusit të nëpunësit civil, në përgjithësi nuk ka pasur më largime të pamotivuara.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti Nikolla!

Zonja Spahiu, fjala për ju.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të falënderoj të gjithë të ftuarit!

Pavarësisht temës që është shumë sensitive, edhe me kryetaren e komisionit e kemi diskutuar gjatë, ne nuk mund t'u shpëtojmë dot deklaratave politike. Kjo është fatkeqësi e madhe, por nuk kemi çfarë të bëjmë. Pra, duhet të mësohemi që në nënkomisionet parlamentare, kur ka çështje kaq sensitive, do të hyjë politika në mes, sepse secili ka qëllimin e vet për të përfutur politikisht.

Të kthehemi te problemi, me të drejtë të gjitha problematikat që ju përmendët janë reale. Fatkeqësisht një pjesë e mirë e ngjarjeve kanë ndodhur në Durrës, ndoshta ngaqë edhe numri i fasonerive është më i lartë se në qytetet e tjera.

Por unë dua ta shikoj problematikën pak më gjerë, përtej të gjithë argumentimeve dhe sugjerimeve që ka bërë shoqëria civile, ne duhet të fokusohemi në dëmin afatgjatë që sjellin, sepse nuk mund të frenojmë dot zhvillimin e ekonomisë.

Spektori i fasonerisë, është një faktor shumë i rëndësishëm dhe një ndihmë shumë të madhe punësimi për gratë dhe vajzat dhe ne duhet ta pranojmë një gjë të tillë, sepse edhe niveli i punonjësve që janë në atë sektor është për atë vend pune, pra nuk punojnë dot në sektorë të tjerë.

Çfarë mund të përmirësojmë ne për ato gra? Unë mendoj që duhet ta ndajmë në tri shtylla, çfarë është emergjente, çfarë është afatmesme dhe çfarë është afatgjatë.

Në pjesën afatgjatë mendoj që ne duhet të insistojmë që bëhen studime për të parë nëse këto lëndë që përdoren aktualisht në fasoneri, është një problematikë që e ngre OBSH-ja dhe Banka Botërore, shkaktojnë dëmtime në organizmin e njeriut. A ka studime ndërkombëtare për të parë në afat gjatë, se çfarë sëmundjesh mund të japin? Pra, a janë kancerogjene? A

shkaktojnë dëmtime në tru? A ndikojnë në shfaqjen e herët të hipertensionit dhe a shkaktojnë dëmtime te gratë shtatzëna? Pra, këto ishin në shtyllën afatgjatë.

Këtë sektor ne e kemi quajtur pozitiv për zhvillimin e vendit dhe të ekonomisë dhe nuk e frenojmë dot, përkundrazi duhet ta nxisim. Pavarësisht problematikave, ne gjatë fushatave shpeshherë kemi bërë vizita në fasoneri dhe kemi parë që ka fasoneri me standarde shumë të mira. Pra, që kur futesh, e kupton që respektohen, nuk flas për kushte minimale, kushtet mesatare të punës. Por kemi parë edhe fasoneri, që, për fat të keq, ishin pa ajrosje dhe me kushte të papranueshme. Prandaj duhen verifikuar kushtet e punës në çdo fasoneri, edhe pse kemi një numër të vogël inspektorësh, them se kjo gjë realizohet.

Ndërsa për problematika që ndodhin aksidentalisht, siç ka ndodhur në rastin e Durrësit, ato janë fenomene të paparandalueshme, sepse ndodhin ashtu siç ndodh kur bie zjarr dhe ti nuk e parandalon dot. Por problematikat që kanë të bëjnë me shëndetin dhe me parandalimin e tyre, mendoj se janë shumë të rëndësishme për t'u fokusuar dhe nuk është vetëm çështje inspektori.

Edhe variantin që theksoi kolegja e kemi dëgjuar, është variant i hershëm dhe do të mbetet, sepse, nuk mund ta çojmë në zero asnjëherë shkallën e korrupsionit.

Kjo punë duhet bërë në grup, me inspektorët e punës, të shëndetit dhe të tjerë, si grup taskforce, pra të bëhet një grup dhe shkojnë për të evidentuar problematikat, sepse duke shkuar veç e veç për të gjithë, bëhen të bezdisshëm. Mund të jetë e drejtë arsyeja e inspektimit, por kur shkon një taskforcë për të gjitha problematikat që ju ngritët këtu, mendoj që është më pozitive, më e pranueshme dhe shkalla e korrupsionit bie, sepse, sido që të jetë, është një grup më i madh njerëzish.

Do të rikthehem tek ajo që tha kolegja Gjebrea, dikur ka qenë një repart i veçantë që merrej me sëmundjet profesionale, por në atë kohë ne kishim më të zhvilluar sektorin e minierave dhe kryesisht aty vinin të sëmurë nga puna e gjatë në miniera, me insuficiencë respiratore. Mos ndoshta ka ardhur koha që të ndryshojë objektivi, sepse ka ndryshuar edhe strategjia e zhvillimit të punësimit? Nuk jemi më te minierat, ka të sëmurë që vijnë edhe nga minierat, por është shtuar më shumë numri i kategorive të tjerave, për të cilat mendoj që duhet të ketë protokolle të reja parandalimi dhe mjekimi për këto gra që duhet të kontrollohen, sepse nuk janë vetëm fasoneritë. Unë kam pasur shumë raste ankesash për punonjësit që punojnë në vende me zhurma dhe pas 10 vjetësh ata shurdhohen. Pra, është e studiuar dhe e vërtetuar që dëgjimi bie çdo vit me një përqindje të caktuar, prandaj duhet të mendojmë për të gjitha llojet e sëmundjeve profesionale që shkaktohen gjatë punës. Për këtë duhet një grup më i gjerë profesional dhe të shikohet në një aspekt më të gjerë.

Unë falënderoj kryetaren e komisionit që u fokusua në një çështje kaq delikate dhe shpresoj që ne ta vazhdojmë këtë bashkëpunim, me qeverinë po e po, por edhe me shoqërinë civile, më të cilën kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë. Studimi që keni sjellë në lidhje me gjendjen e qendrave shëndetësore, pavarësisht se jeni jashtë fushës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, po nuk është objektivi juaj kryesor dhe ju gjetët kohën për t'u angazhuar me një problematikë shumë të rëndësishme siç ishte situata e qendrave shëndetësore në vendin tonë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Fjalën do t'ua jap të gjithëve, por, meqenëse zonja bëri pyetje, po t'ia jap fjalën. Por, ju lutem, shumë shkurt dhe në mënyrë sa më të përmbledhur.

Për çdo gjë tjetër që ju mendoni ta sugjeroni na e dërgoni me shkrim brenda disa ditëve që edhe ne ta adresojmë.

Faleminderit!

Arben Seferaj – Do të përpiqem shumë shkurt t'i përgjigjem zonjës Dhima, nëse e kuptova drejt, pyetja është e fokusuar më tepër te rezultatet e arritura nga Inspektorati i Punës. Unë normalisht mund të them që të gjithë treguesit që përbëjnë shtyllat e vlerësimit në Inspektoratin e Punës kanë ndryshuar, referuar vitit 2017. Pra, në vitin 2018 ka pasur rreth 433 inspektime më shumë, janë marrë 632 masa pezullimi më shumë, kemi marrë 95 gjoba më shumë, paralajmërime kanë marrë 1538 subjekte më shumë dhe kemi formalizuar 939 persona më shumë sesa në vitin 2017, me një total rreth 1600 për këtë vit ushtrimor. Pak a shumë kjo është përgjigjja e shkurtër për sa i përket zonjës Dhima.

Në lidhje me pyetjen që bëri zonja Pampuri, e shikoj si të drejtë pyetjen, sepse ekziston fenomeni i korrupsionit, por nga ana tjetër ne kemi bërë një punë kolosale, prandaj e kërkoja vëmendjen në fillim, për pjesën e vendimmarrjes dhe korrupsionit ne kemi punuar fort te pjesa e matricës së dënimeve, e cila rrit transparencën në mënyrë maksimale dhe heq pjesën abuzive të inspektorëve. Pra, vendimmarrjet dhe standardet e njëjta për shkelje të të njëjtës formë në subjekte të ndryshme heqin gjithë merakun e zonjës Pampuri për shqetësimin që kishte.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti Seferaj!

Po, zonja Braho.

Vjollca Braho – Në përgjigje të pyetjes që bëri deputetja, dua të them që Inspektorati Shtetëror ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Shtetit. Sa herë që ka pasur probleme, jemi njoftuar nga Policia e Shtetit, siç ishte rasti i Durrësit, por edhe kur kemi shkuar për inspektime në subjekte të ndryshme dhe kemi pasur probleme me persona të cilët nuk na

kanë lejuar të futemi në subjektin e tyre ose mbas gjobave që kemi vendosur në përcaktim të ligjit, kemi pasur një mbështetje shumë të madhe nga Policia e Shtetit.

Edhe unë jam e mendimit që duhet të ketë një bashkëpunim shumë më të madh mes institucioneve, për të mos bezdisur subjektet duke shkuar herë pas here për inspektime të ndryshme. Por me vendosjen e sistemit *online* ne e kemi si detyrim ligjor për të dërguar pranë Inspektoratit Qendror të gjitha programet që janë të përcaktuara me muaj dhe atje të bëhet harmonizimi. Pra, nëse brenda muajit ne kemi programe të njëjta me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe të Mjedisit, mund t'i bëjmë inspektimet bashkë. Eksperienca të tilla ka pasur edhe në vitet e mëparshme, pra ka pasur një bashkërendim të institucioneve, ku janë bërë taskforca dhe një punë e tillë sigurisht edhe do të vazhdojë në vitin 2019.

Për atë që tha zonja Pampuri, nuk mund të them asgjë për punën e inspektorëve, për sa i përket korrupsionit, sepse unë kam një javë që kam marrë detyrën. Por në bazë të raporteve që po shikoj, sepse dje kanë filluar analizat vjetore në institucion, është bërë një punë e mirë. Për shembull, dje isha në Durrës, dhe fillova vetëm me problematikat që ne kishim pasur për pjesën e fasonerisë, ku janë bërë edhe ndryshim inspektorësh. Pra, nëse inspektorët janë mësuar ose janë treguar më të butë me subjektet, sepse janë njohur për aq kohë sa kanë punuar, ne i kemi ndryshuar duke i çuar në qytete të tjera, pra inspektorët e Durrësit i kemi çuar në Vlorë, sepse nuk i njohin subjektet e Vlorës dhe anasjelltas. Këtë e kemi bërë për të hequr pjesën e riskut për sa i përket korrupsionit.

Për atë që tha doktoresha, mendoj që ka ardhur koha që në Universitetin e Mjekësisë në QSUT të hapet dega e specializimit për sëmundjet profesionale, sepse në këto momente është e mbyllur edhe pjesa e specializimeve, e cila është e nevojshme.

Nuk është e vërtetë ajo që në bazë të ligjit nuk kemi mjek në subjekte, të cilat janë të ndara sipas grupeve "A" "B" dhe "C", pra kush ka mbi 700 punonjës e ka të përcaktuar duhet të ketë mjek e të tjera, dua të them që kjo gjë ekziston, por janë në fazën e mjekëve të përgjithshëm. Por, nëse kemi sëmundje profesionale, i drejtojmë te profesionistët.

Ajo që duhet të bëjmë në të ardhmen, meqenëse ju jeni një komision që e drejtoni këtë punë, ta çoni më tej zërin tuaj për hapjen e degës për sëmundjet profesionale, për sa i përket specializimeve.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Po.

Klodiana Spahiu – Duke diskutuar me të ftuarën për këtë raport që unë, fatkeqësisht, nuk e kam lexuar, ndoshta ka ardhur sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ky raport i ka të gjitha problematikat për të gjitha fasoneritë e Shqipërisë. Prandaj kërkoj nga Inspektorati, meqenëse është edhe drejtori, që ta shfrytëzojë këtë raport, sepse aty ka shumë problematika.

Unë fola për ato fasoneri që kam parë vetë dhe nuk marr përsipër fasoneritë në të gjithë Shqipërinë. Pra, në Durrës ka fasoneri me kushte shumë të mira, por ka edhe të tjera që mund të përmirësohen.

Por nëse në këtë raport të rëndësishëm janë identifikuar raste me shkelje flagrante të kushteve minimale, atëherë ju sugjeroj që të bëni një verifikim të fasonerive në të gjithë vendin.

E bëra këtë ndërhyrje, sepse ishte një bisedë mes nesh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As unë nuk di, sepse nuk e kam lexuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni – Ju falënderoj të gjithëve shumë për praninë tuaj këtu, por edhe për punën e përditshme që bëni!

Robert Gajda – Në lidhje me çështjet e diskriminimit, sigurisë dhe shëndetit në punë, kemi ankesa që lidhen me punësimin, por kryesisht për largimet nga puna, për shqetësime për vendet e punës, por jo që të lidhen specifikisht me sigurinë dhe shëndetin.

Kolë Nikolla – Vetëm një fjalë, sepse u bëra pak i bezdisshëm sot, por jemi miq.

Nëse vërtet duam që t'i zgjidhim këto probleme, parlamenti dhe qeveria shqiptare duhet të kthejë Ministrinë e Punës dhe Emergjencës Sociale, sepse po ndihen pasojat e shkrirjes së kësaj ministrie dhe një ndër ato është edhe problemi që po diskutohet sot. Por ka edhe probleme të tjera që kanë 2-3 vjet që po agravohen. Nëse do të shkojnë deri në fund të mandatit me këtë situatë, do të ketë edhe probleme të tjera.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zoti Nikolla!

Për ta përmbyllur, ju kërkoj ndjesë për nxitimin! Mbase vërtet kemi lënë gjëra pa thënë, por mendoj që të gjitha sugjerimet, mendimet, gjetjet, studimet apo përvojat tuaja janë shumë të vlefshme për ne si nënkomision, por edhe për institucionet e tjera që ne do t'ua përcjellim.

Këtë seancë dëgjimore nuk e bëmë thjesht për faktin që duam t'u japim rekomandime institucioneve përkatëse, por sepse jemi edhe në rolin monitorues për të parë zbatimin e ligjit, nëse kanë dalë apo jo aktet nënligjore, siç u tha nga kolegu, nëse Inspektorati ka nevojë për më shumë kontribut nga parlamenti, jo thjesht në ligjbërje dhe monitorim, por edhe në sensibilizim, edhe në lidhje me të drejtat e punëtorëve, por edhe për ngritjen e këshillave.

Pra, në vazhdim të të gjithë sugjerimeve dhe komenteve që kemi marrë, ku një pjesë u tha këtu dhe pjesa tjetër na ka ardhur me *email*, do t'ju lutem, nëse keni ndonjë gjë tjetër, na e dërgoni me shkrimi brenda javës tjetër, pra nëse ka diçka që nuk arritëm ta diskutojmë këtu na e dërgoni që ne të ndërmarrim hapa konkretë dhe ta adresojmë si problematikë.

Kjo është një temë shumë e ndjeshme dhe me rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj vlerësoj kontributin e institucioneve shtetërore dhe punën që ato bëjnë, pavarësisht burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare, rolin e Konfederatës së Sindikatave dhe zotit Nikolla, që është gjithmonë shumë aktiv si për kontributin, ashtu edhe për sugjerimet, të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile që punojnë në një terren shumë të vështirë, sepse nuk besoj se ka qenë i lehtë intervistimi i grave për të marrë problematikat e tyre apo dëshmitë reale nga jeta dhe abuzimi i të drejtave të tyre.

Ne si Nënkomision i Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas angazhohemi që do të ndërmarrim disa hapa, për të cilët do të jeni në dijeni dhe do të jemi më proaktivë në ndjekjen, respektimin dhe në zbatimin e tyre.

Faleminderit të gjithëve, shpresojmë të shihem së shpejti për çështjet që na shqetësojnë

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA